



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:167617
Datë: 30.09.2024
Numri i dokumentit: 06229282

K.Dh.Sh II.nr.1063/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbaremore të kreditorit “S...P...” L.L.C., me numër unik identifikues, me seli në Pejë, rr. “...”, p.nr., kundër debitorit “A...” Sh.P.K., me numër unik identifikues dhe me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbaremore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1218/23 të datës 01.03.2024, me datë 25.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit “A...” Sh.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 1218/23 të datës 01.03.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 1218/23 të datës 01.03.2024, ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimi i debitorit “A...” Sh.P.K, me seli në Prishtinë, ndaj Urdhrit Përmbaremore P.nr. 112/23 i lejuar 04.07.2023, nga Përmbareuesi Privat Jeton Krasniqi, nga Peja. dhe Urdhri Përmbaremore P.nr. 112/23 i lejuar 04.07.2023, nga Përmbareuesi Privat Jeton Krasniqi, mbetet në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. 1218/23 të datës 01.03.2024

Kreditore nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditore S...P....” L.L.C, me seli në Pejë, rr. “....”, p.n, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr. 112/23 i lejuar 04.07.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës nr. 041523001-1, e datës 15.04.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 1,863.72 EUR (me shkronja: njëmijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre euro, e shtatëdhjetë e dy euro cent). Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbartimor, me arsyetimin se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbartimor nuk është pranuar nga i njëjti, sepse kompania që nga viti 1992 me 80 punëtor aktiv çdo herë kur Numri i lëndës: 2023:167617 Datë: 01.03.2024 Numri i dokumentit: 05397798 2 (3) 2023:167618 pranon furnizime, për të njëjtat nënshkruan dhe i vërteton përgjegjësi i kompanisë, andaj kjo faturë është e panjohur dhe nuk posedon nënshkrimin dhe vulën e personit përgjegjës. Kreditore në përgjigje në prapësim ka theksuar se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbartimor është nënshkruar nga punëtorët e kompanisë dhe se i njëjti ka pozitën e depoistit për pranim të materialit apo mallit me të cilën e ka furnizuar debitorin. Ka shtuar se lidhur me këtë borxh ka edhe provat – komunikimet që dëshmojnë borxhin e pa paguar nga ana e debitorit. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ashtu që urdhrin përmbartimor ta lë në fuqi.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë duke vendosur lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke ju referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar me arsyetim se sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.” Po ashtu ka shtuar se fatura mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbartimor nga përmbartuesi privat, përmbartuesit privat bazohet në dokument të besueshme, përkatësisht Fatura nr. 041523001-1, e datës 15.04.2023 mbi bazën e të cilës është lejuar përmbartimi, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Tutje gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore nga neni 71 i LPP-së, mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe shkalla e dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar ka konstatuar drejtë faktin se fatura nr. 041523001-1 të datës 15.04.2023, në bazë të cilës organi përbarues ka caktuar përbarimin është dokument i besueshëm e kjo parashihet në nenin 29 paragrafi 1 të LPP-së, ku ceket se: përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm sipas këtij ligji është edhe fatura. Në rastin konkret fatura përbënë bazën juridike për caktimin e përbarimit konform nenit 21 si dhe nenit 29 paragrafi 3 i cili thotë se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, e që në rastin konkret fatura është e nënshkruar dhe e pranuar nga debitori dhe se e njëjta është në origjinal. Andaj edhe kjo gjykatë e pranon përfundimin juridik të gjykatës se shkallës së parë ngase aktvendimi i ankimuar është i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përbarimit në këtë rast.

Në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkallës ë Dytë për te vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë

K. Dh.Sh II.nr. 1063/24 me datë 25.09.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri